

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/01-14433
Dt.06.07.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **“EKO ARK”SH.P.K. me seli në Gjakovë, e regjistruar me nr. të biznesit 70852098, me pronar Xhemajli (Xhafer) Haxhimustafa dhe Ilir (Masar) Hadri**, nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me etazhitet për fazën e parë B+P+6, ndërsa etazhiteti i përgjithshëm i objektit B+P+6, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: “EKO ARK”SH.P.K. me seli në Gjakovë, e regjistruar me nr. të biznesit 70852098, me pronar Xhemajli (Xhafer) Haxhimustafa dhe Ilir (Masar) Hadri, nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, Sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban “Mbretëresha Teutë” dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07/351 - 46263 të datës 16.01.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 1287/1 dhe 1287/2, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të “EKO ARK”SHPK, në rrugën “Mbretëresha Teutë”, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është B+P+6, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit për këtë fazë $S=1633.16 \text{ m}^2$

Bodrumi:	(Sip.Bruto):	$S=171.80 \text{ m}^2$
Përdhesa:	(Sip,Bruto):	$S=214.95 \text{ m}^2$
Kati i parë:	(Sip,Bruto):	$S=250.66 \text{ m}^2$
Kati i dytë:	(Sip,Bruto):	$S=250.66 \text{ m}^2$
Kati i tretë:	(Sip,Bruto):	$S=250.66 \text{ m}^2$
Kati i katërt:	(Sip,Bruto):	$S=250.66 \text{ m}^2$
Kati i pestë:	(Sip,Bruto):	$S=250.66 \text{ m}^2$
Kati i gjashtë:	(Sip,Bruto):	$S=250.66 \text{ m}^2$



II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë “EKO ARK “SH.P.K. - Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

“EKO ARK”SH.P.K. e regjistruar me nr. të biznesit 70852098, me pronar **Xhemajli (Xhafer) Haxhimustafa dhe Ilir (Masar) Hadri**, me seli në Gjakovë në rrugën **“Mithat Frashëri”**, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-14433, dt. 06.06.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me etazhitet për fazën e parë B+P+6, në ngastrat kadastrale ndërtimore me nr. 1297/1 dhe 1297/2, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të lartë përmendurit, në rrugën **“Mbretresha Teutë”** siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:1 000 , të datës 12.01.2017, i punuar nga NSH“Geogauss”- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 05.06.2017, në pronësi të \EKO Ark SHPK të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndës 2829/17, të datës 05.06.2016, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit banimor shumë banesor në me afarizëm në përdhësë, me nr. 351/01-46263, në ngastrën kadastrale me nr. 1287/1 dh 1287/2 :ZK: Gjakovë-Qytet, me të datës 16.01.2017.
5. Raporti mbi kërkimet gjeomekanike në teren si dhe kërkimet laboratorike në lokacionin e parashikuar për ndërtimin e objektit afaristo banesor, me Investitor Lumri Resyli nga Gjakova, në ngastrën kadastrale me nr. 1287/1 dhe 1287/2, të hartuar nga “Geomerkur” Sh.p.k.Gjakovë.
6. Lejen Mjedisore Komunale me nr. 07-351/1 - 15440, dt.03.07.2017, lëshuar nga DUMM.
7. Aktin Noterial - Kontratën për ndërtimin e përbashkët me nr.LRP.Nr.Rendor 1264/17, dt.19.04.2017.
8. Certifikatën mbi regjistrimin e biznesit nga MTI-RKS.
9. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.111/17 me datë 31.05.2017, lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Ministria e Punëve të Brendshme e R.K.S.
10. Pëlqimin Sanitar, me nr. 14/53/14817 të datës 12.06.2017, nga Inspektoriati Sanitar komunal-Drejtoria për Punë Inspektuese.
11. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-L-34 të datës 21.06.2017.7
12. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, dt. 05.07.2017.
13. Pëlqimin nga K.R.U.”Radoniqi”Sh.A.-Gjakovë, me nr.855, dt.04.07.2017.
14. Pëlqimin nga PTK- Sh.A. Gjakovë, të datës 03.07.2017.
15. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Pro Credit Bank, filiali në Gjakovë, të datës 06.07.2017.
16. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga “EKO ARK “SH.P.K. - Gjakovë..

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 7795.50 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit ,
- Arkivës.

Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike

Zenel Shabani, jur.dipl.



U. D. Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Gjakovë Qytet

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m ²
P - 70705029 - 01287 - 1	Parcelë \ Parcela \ Parcel -	348.0
P - 70705029 - 01287 - 2	Parcelë \ Parcela \ Parcel -	174.0



Shkalla / Razmera /Scale: 1:500

Punoi \ Obradio \ Created :
Data \ Data \ Date : 05.06.2017
Koha \ Vreme \ Time : 14:48:17
Nënshkrimi \ Potpis \ Signature
Shënim \ Beleška \ Note :



Aprovoi \ Usvojio \ Aproved : Drejtori \ Direktor \ Director


Nënshkrimi \ Potpis \ Siganture:

K.K. GJAKOVË

Zon. kadastrale : Gj. Qytet

Parcela nr. 1287/1,1287/2

PLAN SITUACIONI



Gjakovë,
12.01.2017

Punoi: Fatmir Bobi tek.

Kontrollloi: Durrije Berisha I.D.A.